



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**

Nr. 01-020/06-0027010/25 dt. 08.05.2025  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 42 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kërkesat Elektronike të datës 02.05.2025 dhe datës 07.05.2025 nga znj. Blerina Kastrati Idrizi - Shefe e Zyrës për Informim, dhe Kërkesën Elektronike të datës 06.05.2025 nga z. Valon Hetemi - Shef i Kabinetit të Kryetarit, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

## **V E N D I M**

**(Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Rregullores për Transparencë dhe Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut)**

1. **Formohet** Grupi Punues për Hartimin e Rregullores për Transparencë dhe Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
  - 1.1. Blerina Kastrati Idrizi – Kryetare, (Zyra për Informim);
  - 1.2. Korab Prekazi – anëtar, (Zyra e Kryetarit);
  - 1.3. Artan Xhaka – anëtar, (Zyra për Teknologji Informative);
  - 1.4. Zenel Çitaku – anëtar, (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
  - 1.5. Mentor Ujkani – anëtar, (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
  - 1.6. Merita Preteni – anëtare, (Sekretaria e Kuvendit);
  - 1.7. Teuta Selmani Pllana – anëtare, (Zyra Ligjore);
  - 1.8. Kushtrim Mehaj – anëtar, (Zyra e Prokurimit);
  - 1.9. Besa Veseli – anëtare, (Zyrtare për Barazi Gjinore);
  - 1.10. Sebahate Tahiri – anëtare, (Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm);
  - 1.11. Bardha Haxhiu – anëtare, (Përfaqësuese e OJQ-ve).
2. Grupi punues është përgjegjës për Hartim të Draft - Rregullores për Transparencë dhe Draft - Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
3. Pas Hartimit të Draft – Rregullores për Transparencë dhe Draft – Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të njëjtat të procedohen për votim në Kuvendin e Komunës, përmes Kryetarit të Komunës.



4. Grupi Punues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës



Bedri HAMZA

**Shtojcë:**

- 1x1 Kërkesat Elektronike të dt. 02.05.2025, dhe dt. 07.05.2025 nga znj. Blerina Kastrati Idrizi - Shefe e Zyrës për Informim;
- 1x1 Kërkesa Elektronike e dt. 06.05.2025 nga z. Valon Hetemi - Shef i Kabinetit të Kryetarit.

**T'i dërgohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Anëtarëve Grupit Punues
- 1x1 Arkivit

